



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1138/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Emine Avdyli – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal (AAK-LDD) dega në Prizren paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1138, Anr.1139, 1140, 1141, 1142 të datës 03.12.2013, të Emine Avdyli – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal (AAK-LDD) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1138, Anr.1139, 1140, 1141, 1142 të datës 03.12.2013, të Emine Avdyli – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1138 /13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 2003A04R nuk figurojnë votat e votuesve të mi potencial, pasi që kjo evidentohet edhe nga rezultatet preliminare të QV. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur Formularin e Rezultateve Zgjedhore për kandidatë.
- Në ankesën Anr.1139/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 2003A04R nuk figurojnë votat e votuesve të mi potencial, pasi që kjo evidentohet edhe nga rezultatet preliminare të QV. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur Formularin e Rezultateve Përfundimtare për kandidatë.
- Në ankesën Anr.1140/13 të datës 03.12.2013 , pretendohet se, në QV2021A/01R nuk janë pasqyruar votat në mënyrë reale, pasi që votuesit shpallin dëshmitë e tyre ku e deklarojnë votën të hapur. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur Formularin e Rezultateve Përfundimtare për kandidatë.
- Në ankesën Anr.1141/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2021A/01R nuk janë pasqyruar votat në mënyrë reale, pasi që votuesit shpallin dëshmitë e tyre ku e deklarojnë votën të hapur. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e ka

bashkangjitur Formularin e Rezultateve Përfundimtare për kandidatë.

- Në ankesën Anr.1142/13 të datës 03.12.2013 pretendohet se në QV2008A/04R nga FPR-ja nuk përputhen rezultatet e votave, pasi që mungojnë 7 vota. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur Formularin e Rezultateve Përfundimtare për kandidatë.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Emine Avdylit – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), ku dyshohet për pa rregullsi, keqpërdorime si dhe mungesë të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1138/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.